РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА - REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
ОПШТИНА ЛИПКОВО - KOMUNA E LIKOVËS
Бр. Nr. 08-742/1
08.08. 2024 год. viti
ЛИПКОВО - LIKOVË

Kryetari

Në bazë të nenit 48, të Ligjit për vetqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RMsë" nr. 05/02), neni 34 të Statutit të Komunës së Likovës ("Fletore zyrtare e Komunës së Likovës" nr. 01-06, 03/15 dhe 01/19), dhe nenit 58, paragrafi 1 të Rregullores së Këshillit të Komunës së Likovës, ("Fl.zyrtare e Komunës së Likovës" nr. 07/22), Kryetari i Këshillit të Komunës së Likovës, sjell:

A K T V E N D I M

për konvokimin e seancës së 40 (katërdhjetë) të KKL-së e cila do të mbahet me dt. 15.08.2024 (e Enjte), me fillim në ora 09:00.

Seanca do të mbahet në sallën e KKL-së, në **Likovë.**

Për këte seancë propozoj këtë:

REND TË DITËS

1. Verifikimi i procesverbalit të seancës së 39-të të KKL-së.
2. **PROPOZIM-VENDIM** për dhënien e pëlqimit të vendimit statutar për ndryshim dhe plotësim të statutit të miratuar nga këshilli drejtues i IKPÇF "RREZJA" Orizare;
3. **PROPOZIM-VENDIM** për dhënien e pëlqimit të vendimit të miratuar nga këshilli drejtues i IKPÇF "RREZJA" Orizare, për regjistrimin e Objektit "Valbona 2001 në Regjistrin qendror të RMVsë;
4. **PROPOZIM-VENDIM** për dhënien e pëlqimit të planit vjetor për punësim për vitin 2025, IKPÇF "RREZJA" Orizare;
5. **PROPOZIM-VENDIM** për dhënien e pëlqimit të raportit vjetor për punë, për vitin 2023-2024, IKPÇF "RREZJA" Orizare;
6. **PROPOZIM-VENDIM** për dhënien e pëlqimit PROGRAMËS për punë për vitin 2024-2025, IKPÇF "RREZJA" Orizare;
7. **PROPOZIM -VENDIM** për emërimin e kandidatit për anëtar në këshillin drejtues në Shtëpinë e shëndetit në Likovë;
8. **PROPOZIM-VENDIM** për miratimin e kërkesës për furnizim me gypa dhe materiale shtesë për përcjelljen e ujërave të zeza në fshatin Mateç;
9. **PROPOZIM-VENDIM** për miratimin e kërkesës për furnizim me gypa dhe materiale shtesë për përcjelljen e ujërave të zeza në fshatin Llojan;
10. **Shqyrtimi** i kërkesës të parashtruar nga KLUBI I shkrimtarëve "Jehona e Karadakut"-Kumanovë Likovë;
11. **Shqyrtimi** i kërkesës së parashtruar nga grup qytetarësh nga fshati Sllupçan, për mjete finansiare për kompenzimin e punimeve për pastrimin e kanalit të ujërave të zeza; dhe
12. **Të ndryshme**.

Këshilli i Komunës së Likovës
Kryetar,
Zekirja Shaini



Këshilli i Komunës së Likovës

PROCESVERBAL

i seancës së XXXIX (tridhjetë e nëntë) të KKL-së i mbajtur më dt. 12.07.2024

Likovë, Korrik 2024

Në seancën e XXXIX-të të KKL-së, të mbajtur ditën e premte me dt. 12.07.2024, me fillim prej ora 09:00, morrën pjesë 18 këshilltarë nga numri i përgjithshëm 19. Seanca u mbajt në objektin e Komunës së Likovës, në sallën e këshillit.

Kryetari i KKL-së, Zekirja Shaini, pasi konstatoi se ka kuorum, fillimisht e hapi seancën me fjalë përshëndetëse, ku dhe më pas propozoi që për këtë seancë të punohet me këtë:

REND TË DITËS

1. Verifikimi i procesverbaleve të sencave të parë të jashtëzakonshme, të XXXVIII-të, dhe të dytë të jashtëzakonshme të KKL-së.
2. Raporti kuartal I IKPÇF "Rrezja" në f.Orizare për periudhën 01.01.2024 deri më 30.06.2024.
3. Raporti kuartal I NKP "Pisha" për periudhën 01.01.2024 deri më 30.06.2024.
4. Raporti kuartal I realizimit të shpenzimeve të Komunës së Likovës për periudhën prej 01.04.2024 deri me 30.06.2024, K1, K2 dhe K3.
5. Propozim-vendim për ndryshimin dhe plotësim-zgjerimin e mjeteve në buxhetin e Komunës së Likovës për vitin 2024.
6. Propozim-vendim për dhënien e pëlqimit të planeve vjetore të SHFK dhe SHMK "Ismet Jashari" të Komunës së Likovës.
7. Propozim-vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me nr.08-505/3 të dt.31.05.2023.
8. Propozim-vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Programit vjetor për rregullimin e tokës ndërtimore për vitin 2024.
9. Korrigjimi I vendimit me nr.08-534/5 të dt.11.06.2024.
10. Shqyrtimi I kërkesave.
11. Propozim-vendim për angazhimin e punëtoreve perms agjencisë për punë të përkohshme dhe puntorë sezonal.
12. Propozim-vendim për dhënien e pëlqimit të planit për punësim NKP"Pisha" Komuna e Likovës.
13. Raporti kuartal I NKP "Pishës" për periudhën prej 01.04.2024 deri 30.06.2024.
14. Propozim-vendim për dhënien e pëqlimit të planit për punësim për Komunën e Likovës.
15. Të ndryshme.

Kryetari i KKL-së pasi e lexoi rendin e ditës para këshilltarëve prezent, e kaloi në votim rendin e ditës dhe e konstatoi se u kalua rendi i ditës.

1. Verifikimi i procesverbaleve të sencave të parë të jashtëzakonshme, të XXXVIII-të, dhe të dytë të jashtëzakonshme të KKL-së.

Zekirja Shaini: Të nderuar, e keni para jush procesverbalet nëse keni diçka urdhëroni, nëse jo shkojmë me votim.

Iljasa Abazi: Përshëndetje, shikojeni te procesverbalet e jashtëzakonshme, te njëri prej tyre mungojnë fletët ose nuk është i plotësuar.

Valon Mustafa: Po është e vërtetë, ashtu është. Atje ku shkojnë dhe printohen materialet, nuk e kanë printuar të gjithin dhe për juve. Në ndërkohë procesverbalet janë të gjitha në rregull. Nëse doni mund të shkoj dhe ti sjell këtu para jush. Fatlumja këshilltarja e tha që materialin ta dërgoni të plotë në e-mail.
Iljasa Abazi: Kërkoj që në mbledhjen e ardhshme ta sjellni atë procesverbal komplet dhe në arhiv të jetë I kompletuar.
Erkan Arifi – Kryetar: Unë mendoj që kjo mos të përsëritet pasi që nuk guxon procesverbali të jetë I tillë, në një vend ndryshe e në një vend ndryshe, kërkoj të ja tërheqni vërejtjen kompanisë ku I printojmë që most ë përsëritet më ky gabim.
Valon Mustafa: Patjetër, urojmë mos të përsëritet kurrë më.
Pika hidhet në votim dhe të gjithë këshilltarët janë "PËR".

2. Raporti kuartal I IKPÇF "Rrezja" në f.Orizare për periudhën 01.01.2024 deri më 30.06.2024.

Aida Shabani – Çerdhja "Rrezja": Përshëndetje për të gjithë, ky raport është 6 mujor dhe është raport për rrogat dhe për gjëra të tjera. Mjete nuk po na i lëshojnë ministria dhe po kemi probleme, madje 3 raste ku ende nuk janë paguar, gjithashtu dhe mjetet për rymë e nxemje.Kemi fol me Ministrinë dhe na kanë thanë aq sa keni të paraparë aq dhe do ti merrni. Ne i kemi 3 të punësuara me kontrat në vepër dhe ende skanë mjete ata. Te raporti vetfinancimit të hyra kemi pas 500.000 denarë, mbetje 70.000 denarë deri me 30.06.2024. Nëse keni diçka urdhëroni lirshëm.

Besim Alija: Un nuk po e shof këtë ?
Aida Shabani – Çerdhja "Rrezja": Besoj se tash po e shifni, drejtoresha është jashtë shtetit dhe nuk ka mund me marrë pjesë. Nëse prindi 3 muaj rend nuk e banë pagesën, atëherë nuk mundet çerdhja me pranu fëmijën. Kemi pas rast kur prindi e paguan direkt, pa i thanë ne, pasi e ndjen atë obligim.
Bastri Rexhepi: Sa janë me kontratë në vepër?
Aida Shabani – Çerdhja "Rrezja": Vetëm 3 persona, 1 përkdhelëse, 2 psikologe, por realishtë janë pak. Ne i kemi vetëm 4 përkdhelëse që janë pak, por kemi mungesë të kuadrit.

Pika hidhet në votim dhe të gjithë ishin "PËR".

3. Raporti kuartal I NKP "Pisha" për periudhën 01.01.2024 deri më 30.06.2024.

Hamdi Sherifi – NKP "Penda": Përshëndetje, materialin e keni, të hyrat dhe të dalurat janë në detaje. Nëse keni diçka urdhëroni.

Pika hidhet në votim dhe të gjithë ishin "PËR".

4. Raporti kuartal I realizimit të shpenzimeve të Komunës së Likovës për periudhën prej 01.04.2024 deri me 30.06.2024, K1, K2 dhe K3.

Xhemail Memeti: Përshëndetje të gjithëve, punë të mbarë për këtë seancë. Ky është raporti për 6 muaj, këtë vit puna është duke ec puna normalishtë, 41.5% është realizu buxheti ky është K1. K2-shi është për obligimet që ju ka kalu afati, është me koorrigjim, strategjia e qeverisë është që borxhet me u zvoglu. K3-shi është për borxhet e kredititm jemi tu lishu sipas rendit. Vërejtja ime është te kamata, ka qenë 1% e tash është 20% për krejt shtetin.

Pika hidhet në votim, 2 janë të përmbajtur, 16 "PËR".

5. Propozim-vendim për ndryshimin dhe plotësim-zgjerimin e mjeteve në buxhetin e Komunës së Likovës për vitin 2024.
Xhemail Memeti: Ky propozim vjen kryesishtl nga gjimnazi, dëshirojnë me punu diçka, kanë nevojë me meremetu objektin. Mjetet janë të atyre, vetëm duhet të ndryshohet pozicioni.
Abdulla Rexhepi: Për çka i lypin këta mjete?
Xhemail Memeti: Ne i bëjmë ridestinimin vetëm , asgjë tjetër. Çështja tjetër ju mbetet atyre.

Pika hidhet në votim 17 "Për" ndërsa 1 i përmbajtur.

6. Propozim-vendim për dhënien e pëlqimit të planeve vjetore të SHFK dhe SHMK "Ismet Jashari" të Komunës së Likovës.

Urim Selmani: Përshëndetje, çdo vit ashtu edhe këtë vit deri në fund të gushtit duhet të jipet pëlqim për planin për punësim për vitin e ardhshëm. Në plan hyjnë punëtorët administrativ dhe teknik. Pas këtij pëlqimi në fund vendos ministria e financave. Nëse keni diçka urdhëroni.
Bastri Rexhepi: Punësimet për çka janë parapa?
Urim Selmani: Te Rilindja 3, një sekretar, një rojtar dhe një hausmajstor. Do të thotë të gjithë janë për penzion çka kanë shku.
Arben Jahija: A ka mundëse me ba kshtu pa sekretar ?
Urim Selmani: E kanë angazhu me kontratë në vepër deri në konkursin e ri.

Pika hidhet në votim, të gjithë janë "Për".

7. Propozim-vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me nr.08-505/3 të dt.31.05.2023.

Nuhi Ajdini: Aga Xhezmi ka hsku në pension dhe tash duhet të zavendpsohet ajo pozitë nga Aida Isaki Morina. Te pika e 2të në vend të Aidës vendoset Jetmir Rexhepi.
Iljasa Abazi: Kush është Aida dhe te tekstshkruesi kam vërejtje, duhet të bëhet emërohet.
Nuhi Ajdini: Në maqedonishtë qëndron ndryshe, ka gabim teknik. Aida është nga f.Sllupçan.

Pika hidhet në votim dhe të gjithë janë "PËR".

8. Propozim-vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Programit vjetor për rregullimin e tokës ndërtimore për vitin 2024.
Nuhi Ajdini: Këto mjete te programi vjetor duhet të shtojmë plus në këtë program edhe për tokën ndërtimore. Kjo është e gjitha.
Bastri Rexhepi: Në komisionin e financave, në atë kohë disa muajve, ne ishim që mjetet të hiqen të pakësohen për ndërtimet pa leje, dhe të destinohen ndokund tjetër.

Pika hidhet në votim, dhe të gjithë ishin "PËR".

9. Korrigjimi I vendimit me nr.08-534/5 të dt.11.06.2024.

Dije Arifi: Përshëndetje, bëhet fjal për Kipperin në f.Likovë, ku parcela është e njejtë, mirpo është dashur të bëhet dhe një pjesë e parcelës tjetër kadastrale.
Besim Alija: Krejt e qartë Dije, po kur bëjmë ndryshime ju lutem ta kemi edhe vendimin final dhe paraprak.

Dije Arifi: Ke të drejtë me qenë se vendimi paraprak ka kalu këtu në këshill, tash vetëm se bëhet ndryshimi.
Iljasa Abazi: Më në fund më erdh mire që pranohet diçka që është gabim nga ana juaj.
Zekirja Shaini: Kjo është hera e pare, duhet me u përmisu.

Pika hidhet në votim dhe të gjithë "PËR" ishin.

Dije Arifi: Te pika shtesë krejt e njejta veç në 20(10) kw është desht me shut në vendimin me nr.08-260/9, prandaj un isha ajo që insistova të bëhet ky përmisim.
Abdulla Rexhepi: A është kjo për kabllin tokësor apo ?
Dije Arifi: Po ashtu është, prandaj më mire është të përmisohen.
Abdulla Rexhepi: Teksti për ndërtimin e një termocentrali tash a termocentral apo fotovoltaik ?
Dije Arifi: Po e paskam gabu, termocentrali ndërsa në Maqedonishtë është mire, projektantët po thojnë me cek komplet për atë.

Pika hidhet në votim, të gjithë ishin "Për".

Zekirja Shaini: Para se me kalu te pikat e tjera, le ti kalojmë njëherë pikat për NKP "Pisha".

11.Propozim-vendim për angazhimin e punëtoreve perms agjencisë për punë të përkohshme dhe puntorë sezonal.

Valdete Ramadani – PISHA: Përshëndetje, ktu ndodhen punëtorët sezonal, sepse neve na duhen me kontrata në vepër për sezonën e verës. Tash e kemi edhe eskavatoprin dhe neve na duhen patjetër punëtor të ri sezonal.

Arben Jahija: Përshëndetje, Krejt pajtohem me këtë pike vetëm se kam të qartë ku shkruan te mirëmbajtja e hapsirave publike 7, pse ?

Valdete Ramadani – PISHA: Disa janë, por bëhet fjalë për te varrezat e dëshmorëve, e disa janë edhe me vendim. Do të thotë për hapsirat publike të Komunës.

Besim Alija: Tu e pa minusin, a mundemi ta përballojmë ?

Valdete Ramadani – PISHA: Këto janë sipas nevojës.

Besim Alija: Pse tash ky minus, a nuk ishte plus ?

Valdete Ramadani – PISHA: Është shkaku I rrogave për punëtorët e terenit ku ju lshova rroga para festes tani që ishte.

Abdulla Rexhepi: Këto a janë të punësum për hapsira publike ?

Valdete Ramadani – PISHA: Krejt janë përfshi, andaj gjithçka është e mbuluar.

Arben Jahija: A mundet që edhe përmendorja e heroit në f.Orizare të pastrohet nga ana juaj, nga këta puntorë, pasio aty përveç Balës ndonjëherë askush se pastron. Të paktën 1 herë në muaj.

Valdete Ramadani – PISHA: Do të mundohemi!

Iljasa Abazi: A janë stabil punëtorët me rroga ?

Valdete Ramadani – PISHA: Ne i ndajmë, njëher marin rroga punëtorët e terenit dhe mandej administrata.

Pika hidhet në votim dhe të gjithë ishin "PËR".

12. Propozim-vendim për dhënien e pëlqimit të planit për punësim NKP"Pisha" Komuna e Likovës.

Valdete Ramadani – PISHA: Te plani për punësim duhet të kaloje ashtu sikur dhe institucionet tjera dhe mandej duhet me u dorëzu te ministria e informatikës dhe administratës. Gjithçka është e cekur, ne këtu parashofim, e sa realizohen atë se dijmë.

Pika hidhet në votim dhe të gjithë ishin "PËR".

13. Raporti kuartal I NKP "Pishës" për periudhën prej 01.04.2024 deri 30.06.2024.

Valdete Ramadani – PISHA: Ju po i shikoni, të gjitha janë të klasifikume, minusin e sqarova më herët, ne urojmë të vazhdojmë mirë ashtu si duhet.

Pika hidhet në votim dhe të gjithë ishin "PËR".

Pyetje !?

Abdulla Rexhepi: Te ne gati 3 javë nuk e kanë marrë bërllogun, kur do ta marrin ?

Valdete Ramadani – PISHA: A vetëm te ju, apo edhe te komplet lagja ?

Erkan Arifi – Kryetari: Ato thane se janë marrë veshë me shoqatën Fauna me e nda terenin, prandaj qëllimi ishte që njerëzit jashtë Komunës tonë mos me u lanë në teritorin tonë të futen.
Zekirja Shaini: Të nderuar këshilltarë, kryetari propozon 60.000 denarë, votojmë...

Pika hidhet në votim, të gjithë janë "PËR".

Zekirja Shaini: E kemi një kërkesë tjetër për pastrimin e përrockës në f.Hotël, ku kërkohen 300 euro për pastrim.
Erkan Arifi – Kryetari: Ato ishin në takim te unë dhe kërkuan 300 euro, andaj mendoj se duhet ti mbështesim.

Pika hidhet në votim, të gjithë janë "PËR".

Zekirja Shaini: Kërkesë nga shoqata e pensionistëve për hapjen e klubeve të pensionistëve në Mateç dhe në f.Likovë.
Erkan Arifi – Kryetari: Tek unë kanë kërku një takim një grup e pensionistëve, ata kërkojshin 4 zyre dhe ne madje ua propozuam që në çdo fshat të ketë zyre dhe jo vetëm në 2 fshatra. Kjo është e mire pasi pensionistët me I shfrytëzu benefitët nga pensioni për shfrytzimin e mundësive për pagesa nëpër banja, e me rradhë. Unë mendoj se zyre udhet me ju dhanë, port ë vendoset si kusht që me hap zyre në çdo fshat.
Arben Jahija: Kush I furnizon me mjete ato zyre, ato apo?

Erkan Arifi – Kryetari: Po ato vetë. Ne jemi për me formu një komision dhe caktojmë një takim me msusin Nazim dhe mandej ju japim leje. Çdo fshat me pas me nga 2 anëtarë dhe zyrja të mbetet hapur çdo herë. Zyre me ju dhan po, ashtu mendoj, por të shkruhet si vërejtje siç thash që çdo fshat me pas zyre veçmas. Kërkoj që kërkesa mos me kalu njëherë pa e formu një komision, dhe me ja cek se fshatrat me pas zyren hapur çdo here. Le ta formojmë Komisionin bashkarishtë...
Komisioni: Xhemail Memeti, Iljasa Abazi dhe Rexhep Zendeli.
Zekirja Shaini: Open Tv me kërkesë kërkon mjete për inçizimin e materialeve historike për të gjitha fshatrat. Unë materialet I kam pa edhe vetë dhe mendoj se duhet me I ndihmu në mes 30.000-40.000 denarëve.
Erkan Arifi – Kryetari: Ky e ka ba një punë shumë të mire dhe ky ka kërkuar që harxhimet elementare me ja mbulu e unë I thash bëje një kërkesë dhe mandej e pash shumën se ishte shumë, dhe unë mendoj me ja lëshu 40.000 denarë.
Iljasa Abazi: Dokumentët I kam pa, dhe aty hynë në detaje gjithçka dhe kjo merr edhe shumë kohë që në fund ta kemi ne atë product final. Mendoj se 200 euro janë pak dhe mbetet kjo gjithmon si document. Nëse I jepni 200 euro, un kisha thanë hiç mos me ndihmu për aq mjete.
Zekirja Shaini: Mos harro se ai prej asaj ka edhe përfitime, prandaj unë mendoj se 40.000 denarë janë të mjaftueshme.
Erkan Arifi – Kryetari: Kjo ka ndodh e njejta nga mos koordinimi në kohë. Projekti më ka pëlqy dhe aj më tha se e ka mundësi diçka Komuna me na ndihmu, pak për harxhimet. Mundësi ne kemi deri 40.000 denarë. Ai e ka shënu shumën aq, mirpo ne nuk mundemi aq. Nëse aj thot pak, atëherë ne e shofim dhe tek e fundit aj e ka bë këtë vetë jo se ne i kemi thënë.

Pika hidhet në votim dhe vendoset për 40.000 denarë, të gjithë ishin "PËR".

Erkan Arifi – Kryetari: Kërkesa e ekspres media,ata ishin në takim te unë dhe më than se ata mirren me transparencë, un sit hash asgjë, ndoshta ju e njifni dhe ju vendoseni.
Arben Jahija: Un e njof perms rrjeteve sociale, aj më tha me i ndihmu, un spe di por ndoshta u bënë shumë ndihma të tilla.
Erkan Arifi – Kryetari: Ne jemi shoqat e pavarur e gazetarëve shqiptarë më thanë për transparencë.
Iljasa Abazi: Ne duhet të jemi të kujdesshëm se kujt i lëshojmë dhe anën e kujt e mban. Kjo qenka nga Shkupi, tani ne e kemi edhe Inën e Naserit të cilin in e çmoj shumë. Nuk po e njof këtë, duhet me pas kujdes.
Erkan Arifi – Kryetari: Kym ë tha se ne sjemi portal, por ne jemi shoqat për punë, takime, seminare, për gazetarët shqiptarë. Nëse çdo komunë ka marrë pjesë, duhet edhe ne të marrim pjesë e mos të ndahemi.

Abdulla Rexhepi: Te pjesa mediatike, ne se dihmë se kush është pronari dhe mediat po krijojnë një huti për të gjithë neve dhe popullatën.
Zekirja Shaini: Askushspo e njef, prandaj mos me humb kohë...
Erkan Arifi – Kryetari: Jo në fakt ky njihet, por ne këtu se njofim.
Nevzad Asipi: A nuk bane kryetar 1000 denarë me ja lishu, në atë mënyrë që mos ta kthejmë mbrapa ?
Zekirja Shaini: Kërkohet material shtesë, informatë për séance e ardhshme me sjell se kush është, çka vepron e kështu me rradhë.
Urim Selmani: Me kanalizimet e keni pa besoj punën, procesverbalet I keni të gjithë, janë 3 me ujra të zeza dhe 1 për kanalet atmosferike. Punën e bëjnë vetë banorët, ndërsa materialin ne.

Pika hidhet në votim dhe të gjithë ishin "PËR" për kanalizimet.

Bastri Rexhepi: Çka është puna në f.Nikushtak për bekatonkët ?
Erkan Arifi – Kryetari: Ne në takimin e fundit në Nikushtak e thamë se mënjëherë pas punëve për ujin vazhdojmë tea to rrugica që I kemi prioritet. Kjo vlen edhe për fshatrat e tjerë. Le të mirremi vesh se cilat rruga.
Arben Jahija: Bekatonizimi në rregull, por ju lutem puna e paushallit për ne ku mbetet, sepse çdo muaj po e shtyjmë, dhe gjithashtu prioritet ti jipet dhe përroit në f.Orizare.
Erkan Arifi – Kryetari: Po për fshatin Orizare ka projekt, leje ka, dhe kemi apliku te UNDP dhe kemi duke prit përgjigje, tash urojmë që të kaloj, nëse jo mbetet të shihet me apliku dikund tjetër. Për rrugicët 8 I kemi kry, dhe 2 janë duke u prit. Për paushallin, Xhema më ka thane me bë ribalanc sepse nuk ka mjete, ndërsa para séances së ardhshme do ta mbajm 1 takim me koordinatorët në zyren time.
Zekirja Shaini: Qerimit I kërkoj falje publike sepse pak mjete I kanë lëshu, te mbledhjet e rregullta nuk dua aryetim, te të jashtëzakonshmet nëse rendi I ditës është 1 javë para as këtu nuk dua arsyetim ta dini.
Abdulla Rexhepi: E nëse mungon me arsye, a arsyetohet ajo mungesë ?
Erkan Arifi – Kryetari: Valoni sa më tregoj se kemi pas rast ku këshilltarja Qendresa ka qenë shtatëzane dhe në atë kohë ka mungu dhe mjetet nuk ju kanë lëshu, edhe pse mungesa ka qenë me arsye. Qerimi duhet me tregu se ku me ja lan materialin, e për këto që janë jashtë shtetit këtu as që ka diskutim!
Abdulla Rexhepi: Në parlament është edhe ndryshe, edhe pse mungon ata paguhen.
Erkan Arifi – Kryetari: Në parlament çdo deputet ka të krijuar mardhënie pune, nëse shkojmë sipas ligjit këtu lëshohen mjete vetëm për pjesmarrje. Kur e analizon vërtet është e pakapshme, por kështu është.
Rexhep Zendeli: Un kam pyetje dhe kërkesë. Për rrethojën e deponisë kur fillojnë punët? Rrruga Vishticë-Nikushtak kur fillon asfaltimi? Po ndjehemi të revoltum pse 8 rrugë në f.Orizare, e te ne asnjë rrugë. Dhe gjithashtu të vendoset patjetër një klim në sallën e këshillit.
Erkan Arifi – Kryetari: Rrethoja: Procedura është kry, ne kemi pas fillu me fillu në ditën kur ke minstri, por e lam atë ditë jo, dhe pas 1 jave ose 10 ditëve fillon puna. Projekti i deponisë është qysh nga viti 2017, dhe ne jemi pjesmarrës aty, kjo temë është e moçme dhe deri sat ë kryhet ajo punl ne do ta bëjmë rrethojën e përkohshme. Është parapa nga asfalti të mbyllet deponia, dhe të lihet vetëm një rrugë e vogël për kalim të mjeteve nga rruga në deponi, të vendoset një barakë dhe mandej të vendoset një shumë participimi për të gjitha mjetet që dëshirojnë të futen aty. Për rrugën Vishticë-Nikushtak me project ishte 3.5 metra, mandej gjendja ishte 4 metra dhe ne e morrëm iniciativ të bëhet 4 metra. Kjo është puna dhe na kanë thane se deri sot me u kry procedura dhe nesër me fillu.
Bastri Rexhepi: Asfallti vjetër me u përdor, ne u morrëm vesh që ta përdorim për në f.Nikushtak. Mirpo asnjë kamion nuk ka ardhë.
Erkan Arifi – Kryetari: Asfalti është heq krejt dhe ne e kemi çu te deponia pikëristë se janë copa të mëdhaja. Te deponija u kallke, dhe ne I kemi çu atje I kena mbulu mbeturinat dhe ajo pak na ka ndihmu.
Jahi Jahija: Ka qenë e pamundshme me u shfrytëzu për shkak se ka qenë me pjesë të mëdha, dhe jo copëza të vogla.
Abdulla Rexhepi: Azemini ku po i ka plastikat shumë bërllog po bëhet atje ?

Zekirja Shaini: Realishtë ajo duhet me u heq, unë edhe vet kam qenë te inspektorati dhe jam interesuar. Aj është duke e shfrytëzuar pronën publike e cila shkon në dëm të qytetarëve.
Abdulla Rexhepi: Kur do mbahet seanca në gusht ?
Erkan Arifi – Kryetari: Besoj se deri me 12 gusht nuk do të ketë mbledhje.
Qerim Zimberi: Ku ka arrit procedura me shkollën periferike "Dituria"?
Erkan Arifi – Kryetari: E gjitha është kry veç me fillu puna. Në Opaj, në Hotle projektet janë ende në status të pazgjidhur.

Pasi u shqyrtuan të gjitha diskutimet seanca mbaroi në ora 11:48'.

Procesmbajtës: Aida Isaki Morina

Këshilli i Komunës së Likovës
Kryetar
Zekirja Shaini

РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА - REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
Општина Липково - Komuna e Likovës
ЛИПКОВО - LIKOVË

Примено E pranuar 09.08.2024			
Орг. един. Njësia org.	Број Numri	Прилог Bashkangjitur	Вредност Vlera
08	744/1		

DERI TE:

Komuna e Likovës – Këshilli i Komunës së Likovës

Lënda: Dorëzim për miratim të Raportit vjetor për punë të Institucionit për vitin shkollor 2023-2024 dhe miratimin e Programës për punë të Institucionit për vitin shkollor 2024– 2025 viti.

Të nderuar,Në bazë të nenit 116 alineja2 e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve Gazeta zyrtare e R.M me nr.23/13,12/14,44/14,144/14,10/15,25/15,150//15, 192/115,...dhe Gazeta zyrtare Republikës së Maqedonis Veriut nr.104/19,146/19 dhe 275/19 viti,kërkojm nga ana Juaj që ta miratoni Raportin vjetor të IPKÇF Rrezja- fsh.Orizare, Likovë për vitin shkollor 2023 -2024 si dhe Programën për punë të IPKÇF Rrezja fsh. Orizare,Likovë për vitin shkollor 2024 – 2025

Në shtojcë ju dorëzojmë:Raporti vjetor për vitin shkollor 2023 -2024

- Programa për punë për vitin shkollor 2024 – 2025.
- Vendimi I Këshillit Drejtues për miratimin e Raprtit vjetor për vitin 2023 – 2024
- Vendimi I Këshillit Drejtues për miratimin e Programës vjetore për punë për vitin shkollorë2024– 2025.
- Plani për punësim për vitin 2025
- Vendimi I planit për punësim
- Vendim për dryshimi dhe plotësim të Statutit të IPKÇF ,,Rrezja,,fsh.Orizare
- Vendim për regjistrimin e flijalit-objektit ,,Valbona 2001,, në përbërje të IPKÇF ,,Rrezja,, fsh.Orizare.

Përpunoi:Miradije Ibishi

Me respekt IKPÇF,,RREZJA,,f.Orizare-Likovë

Drejtorë Sabrije Saiti

ДО:

03 – 744/1
08 08 24

Општина Липково -Совет на Општина Липково

Предмет: Доставување за усвојување на Годишен Извештајот за работа на установата за учебна година 2023-2024 година и усвојување на Годишна програма за работа на установата за 2024-2025 год.

Почитувани, Врз основа на член 116 алинеја 2 од Законот за заштита на децата Службен весник на Р.М бр.23/13, 12/14 ,44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/115,....и Службен весник на Република Северна Македонија бр.104/19, 146/19 и 275/19 год,бараме од Вашата страна усвојување на Годишен Извештај за работа на ЈОУДГ Резја с.Оризаре – Липково за учебна година 2023-2024 како и за Годишна Програма за работа на ЈОУДГ Резја – с.Оризаре,Липково за ушебната година 2024 – 2025год. Во прилог ви доставуваме Годишен Извештај за работа на установата за 2023– 2024 година.

- Годишна Програма за работа на установата за 2024 – 2025 година.
- Одлука на Управниот Одбор за усвојување на Годишен Извештај за работа на установата за 2023– 2024 г
- Одлука на Управниот Одбор за усвојување на Годишна Програма за работа на установата за 2024 – 2025 година.
- План за вработување 2025
- Одлука за планот за вработување
- Одлука за измена и дополнување на Статутот на ЈОУДГ ,,Резја,, с.Оризаре
- Одлука за упис на подржница-објектот ,,Валбона 2001,, во состав на ЈОУДГ ,,Резја,, с.Оризаре.

Со почит,р
ЈОУДГ ,,Резја,,с.Оризаре –Липково
Директор
Сабрије Саити

Врз основа на член 116 од Законот за заштита на децата, („Службен весник на Република Македонија" бр. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, И 21/18,) и член 27 став 1 од Статутот на ЈОУДГ „РЕЗЈА" во Оризаре, Општина Липково, Управниот одбор на детската градинка ЈОУДГ „РЕЗЈА" во Оризаре на седницата одржана на ден 08.08.2024 година, донесе

О Д Л У К А

за упис на подружница –Објект Валбона "2001", во состав Јавната општинска установа за деца Детска градинка ЈОУДГ „РЕЗЈА" во Оризаре, Општина Липково

Член 1

Се донесува Одлука за упис на подружница - Објект **Валбона "2001"** во состав на Јавната општинска установа за деца – Детска градинка ЈОУДГ „РЕЗЈА" во Оризаре, Општина Липково

Член 2

Адреса на подружницата - **Објект Валбона "2001" е с. Матејче (без уличен систем), Општина Липково.**

Член 3

Овластено лице на подружницата - **Објект Валбона "2001"** е директорката на Јавната општинска установа за деца – Детска градинка ЈОУДГ „РЕЗЈА" во Оризаре, Општина Липково Сабрије Саити со ЕМБГ 0608969935005, адреса на живеење во с. Оризаре, Општина Липково.

Член 4

Оваа одлука влегува во сила со денот на донесување, а ќе се примени за упис во Трговски регистар и регистар на други правни лица во Централниот регистар на Република Северна Македонија.

Бр.
08.8.2024

Në bazë të nenit 116 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15. , 192/15, 27/16, 163/17, dhe 21/18), dhe neni 27 paragrafi 1 nga Statuti IKPÇF "RREZJA" Orizare, Këshilli Drejtues i çerdhes për fëmijë, IKPÇF "RREZJA" Orizare, në seancën e mbajtur më datë 08.08.2024., miratoi

V E N D I M

për regjistrimin e filijalit -Objektit "Valbona 2001" në përbërje të Institucionit komunal publik -çerdhes për fëmijë IKPÇF "RREZJA" në Orizare, Komuna e Likovës

Neni 1

Sjellet vendimi për regjistrimin e filijalit -**Objektit "Valbona 2001"** në përbërje të Institucionit komunal publik -çerdhes për fëmijë IKPÇF "RREZJA" në Orizare, Komuna e Likovës

Neni 2

Adresa e filijalit-Objektit **"Valbona 2001"** është fsh. Mateç (pa sistem adresar), Komuna e Likovës.

Neni 3

Personi i autorizuar i filijalit-Objektit **"Valbona 2001"** është drejtoresha e "Objektit amë IKPÇF "RREZJA" në fshatin Orizare" Sabrije Saiti me NVA nr. 0608969935005, dhe me vendbanim në fshatin Orizare Komuna e Likovës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit, do të zbatohet, kurse do të aprovohet me regjistrimin në Regjistrin tregtar dhe regjistrin juridik në Regjistrin qëndror të Republikës Maqedonisë Veriut.

Управен Одбор/Këshilli Drejtues
Претседател/Kryetar,
Нуран Фазлија / Nuran Fazlija

Врз основа член 36, став 1, точка 15, од Законот за локалната самоуправа („Службен весник на РМ“ бр. 05/02), член 40, став 1, точка 43, од Статутот на Општина Липково („Службен гласник на Општина Липково„ бр. 01/06, 03/15 и 01/19), Советот на Општина Липково на одржана 40-та седница на 15.08.2024 година, донесе:

Предлог ОДЛУКА
за давање согласност на одлука за упис подружница објект „Валбона 2001„ во состав на ЈОУДГ „РЕЗЈА“ во с. Оризаре

Член 1

Со ова Одлука Советот на Општина Липково, дава согласност на одлука бр. 03-105/1 од 08.08.2024 година, за упис на продружница Објект „Валбона 2001“ (адреса с. Матејче), во состав на матичниот објект ЈОУДГ РЕЗЈА -Оризаре, одобрен од страна на Управниот одбор на ЈОУДГ „РЕЗЈА“ - Оризаре.

Член 2

Одлука се влегува на сила на денот на донесувањето и ќе се објави и на „Сл.гласник на општина Липково“.

Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, pika 15, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta Zyrtare e RMsë” nr. 05/02), neni 40, paragrafi 1, pika 43, të Statutit të Komunës së Likovës (“Fletore zyrtare e Komunës së Likovës” nr. 01/06, 03/15 dhe01/19), Këshilli i Komunës së Likovës, në seancën e 40-të, të mbajtur më datë 15.08.2024 miratoi:

Propozim VENDIM
për dhënien e pëlqimit të Vendimit për regjistrimin e filijalit objekti “Valbona 2001” në përbërje të IKPÇF “RREZJA” në fsh. Orizare

Neni 1

Me këtë Vendim, Këshilli i Komunës së Likovës, jep pëlqim Vendimit nr. 03-105/1 më datë 08.08.2024, për regjistrimin e Filijalit Objektit “Valbona 2001” (adresa fsh. Mateç) në përbërje të IKPÇF “RREZJA” - Orizare, të miratuar nga Këshilli drejtues i IKPÇF “RREZJA” - Orizare.

Neni 2

Vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe do të shpallet në “Fl.zyrtare të Komunës së Likovës”

Совет на О. Липково /Këshilli i K. së Likovës
Претседател/Kryetar,
Zekirja Shaini

03-1041/1
08.8.24

Врз основа на член 116 од Законот за заштита на децата, („Службен весник на Република Македонија" бр. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18, 198/18 и „Службен весник на Република Северна Македонија" бр. 104/19, 146/19, 275/19, 311/20, 294/21, 150/22 и 236/22), член 26 и 27 од Статутот на ЈОУДГ „РЕЗЈА" во Оризаре, Општина Липково Управниот одбор на детската градинка ЈОУДГ „РЕЗЈА" во Оризаре на седницата одржана на ден 08.08.2024. година, донесе

СТАТУТАРНА ОДЛУКА
за измена и дополнување на Статутот на Јавната општинска установа за деца Детска градинка ЈОУДГ „РЕЗЈА" во Оризаре, Општина Липково

Член 1

Се врши изменување и дополнување на Статутот на Јавната општинска установа за деца – Детска градинка ЈОУДГ „РЕЗЈА" во Оризаре, Општина Липково со архивски бр. 03-5/1 од 16.10.2015 година, изменет и дополнет со Статутарна одлука бр. 01-34/1 од 21.06.2019 година.

Член 2

Управниот одбор на седницата одржана на 08.8.2024 година, донесува Одлука за измена и дополнување на Статутот на ЈОУДГ „РЕЗЈА" во Оризаре, Општина Липково.

Член 3

